



Npi – 01/131 datë: 03.04.2025

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 shkronja (o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 7, 8, 10 të Ligjit për Sistemin e Adresave në Republikën e Kosovës Nr.04/L-071; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi listën e Kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve Npi – 01/45 datë: 12.02.2025, dhe duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komisionit Npi-01/60 të datës 13.03.2025, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/118 të datës 01.04.2025, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 03.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS TË HYZER GASHI

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 03.04.2025, me shumicën e votave vendosi të REFUZOJË Kërkesën Nr: 06-350/02-30308/24 datë: 20.11.2024, të Hyzer Gashi nga fshati Pjetërshticë, për emërtimin e një rruge të re në Shtime me emrin “Idriz Ajët Gashi”.

II

K ë r k e s a: z.Hyzer Gashi, Pjetërshticë, Kërkesa Nr: 06-350/02-30308/24 datë:20.11.2024, ka kërkuar emërtimin e një rruge të re në Shtime me emrin “Idriz Ajët Gashi”. Rruga gjendet në Zonën Kadastrale – Shtime, e që lidhet me rrugën “Komandant Kumanova” dhe shkon deri te “Liqeni i Mjellmave” dhe fabrika e lëngjeve “Bion”. Emri i propozuar i përket familjarëve të palës. Kërkesa është individuale dhe nuk ka ndonjë petition ose nënshkrime të banorëve të zonës. Për emrin e propozuar pala ka ofruar një biografi të shkruar të marrë nga libri i Prof.dr. Emin Kabashi me titull “Lufta Kundër Robërisë dhe Historia” (Idriz Ajët Gashi – Jeta dhe Vepra).

III

- A r s y e t i m: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 06.12.2024, unanimisht miratoi Konkluzionin Npi – 01/402 me të cilin vendosi që kërkesën Nr: 06-350/02-30308/24 datë: 20.11.2024, të z.Hyzer Gashit nga fshati Pjetërshticë, ta shqyrtoi pak më detaisht, duke kërkuar nga pala informacione shtesë, lidhur me atë, nëse pala është i pajtimit, që rruga të emërtohet me një emër tjetër, sepse në Komunën e Shtimes është një rrugë e emërtuar me emrin e “Idriz Ajëti”. Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 18.02.2025, me rekomandimin Npi-01/60, pas grumbullimit të informatave, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, Refuzimin e Kërkesës Nr:06-350/02-30308/24 datë: 20.11.2024, të Hyzer Gashi – Pjetërshticë.
- Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 01.04.2025 miratoi Rekomandimin, Npi – 01/118, me të cilin Kuvendit të Komunës i Rekomandon Refuzimin e kërkesës Nr:06-350/02-30308/24 datë: 20.11.2024, të z.Hyzer Gashit – Pjetërshticë.
- Duke marrë parasysh të gjitha këto Kuvendi mori vendim sikurse në Dispozitiv.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi